



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201400553/2

Tiranë ___/___/2014

Lënda: *Rekomandojmë rishqyrtimin e dokumentacionit të dosjes së pensionit të pleqërisë të shtetasit B.Z.*

Drejtuar : **Drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore**

D U R R Ë S

Zoti Drejtor,

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetasi B.Z, lidhur me mosmarrje të përgjigjes për kërkesat e tij për rishqyrtim të dokumentacionit të dosjes së tij të pensionit të pleqërisë.

Sipas shpjegimeve të tij, ankuesi është përfitues i pensionit të pleqërisë. Ka punuar 30 vite si ushtarak dhe 13 vite në portin e Durrësit dhe pretendon se masa e pensionit të tij është e ulët bazuar në vjetërsinë e punës. Gjithashtu për periudhën Shkurt-Maj 2013 nuk i është dhënë drejta e përfitimit të pensionit suplementar si ushtarak.

Meqënëse nuk ka patur asnjë informacion mbi arsyet e mosdhënies së pensionit suplementar për periudhën e sipërcituar, prej një viti ankuesi ka kërkuar pranë institucionit tuaj rishqyrtimin e dokumentacionit edhe për llogaritjen e masës së pensionit të pleqërisë, por edhe pas interesimit të vazhdueshëm, shtetasit B.Z nuk i është kthyer asnjë përgjigje zyrtare.

Duke e konsideruar këtë çështje si shkelje të të drejtave të ligjshme të tij, ankuesi ka kërkuar ndihmën e Avokatit të Popullit për të mundësuar rishqyrtimin e dokumentacionit të dosjes së pensionit të pleqërisë.

Institucioni i Avokatit të Popullit, si një institucion kushtetues në mbrojtje të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj, ka vendosur pranimin e ankesës dhe shqyrtimin e saj.

Sa më lart, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”, si dhe në bazë të nenit 21/b të Ligjit “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se : “Paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,

REKOMANDOJMË:

Rishqyrtimin e dokumentacionit të dosjes së pensionit të pleqërisë të shtetasit B.Z, lidhur me mosdhënien e pensionit suplementar të ushtarakut për periudhën Shkurt-Maj 2013 si dhe rilogaritjen e masës së pensionit të pleqërisë.

Në përputhje me nenin 22 të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet shprehimisht se;

“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet të shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit”,

Lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin Tuaj ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në bashkëpunimin Tuaj,

AVOKATI I POPULLIT
Igli TOTOZANI

Me Urdhër dhe me Porosi
ND/KOMISIONER
Frederik PASKALI